VENDIM
Nr. 201, datë 4.12.2017

PËR MIRATIMIN E "METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT"

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2017, mbasi shqyrtoi "Draftmetodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit".
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti